

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E PUNËS DHE MIREQENIES SOCIALE / MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ŽAŠTITE / MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE

**MINISTRIA E PUNËS DHE MIREQENIES SOCIALE**

**KONTRATA**

**Titulli: " Furnizim me garderobë për AIP "**

Nr1 i prokurimit

209-20-5678-1-3-6


Nr i brendshëm

MPMS-209-20-016-136

**OPERATORI EKONIMIK I SHPËRBLYER ME KONTRATË:**

Seykos SH.P.K., 28 Nëntori - Dardani, -, PRISHTINË

<sup>1</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit



## KONTRATA

**MINISTRIA E PUNES DHE MIREQENIES SOCIALE**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

Seykos SH.P.K., 28 Nëntori - Dardani, -, PRISHTINË (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike për:

**Titulli i kontratës: "Furnizim me garderobë për AIP" me numër Identifikues 209-20-5678-1-3-6**

**Neni 1                    Lënda**

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **"Furnizim me garderobë për AIP "**

		Përshkrimi	Njesia	Sasia
1	Pantallonat dhe sakot (Kati) për meshkuj për Inspektoratin e Punës	<p>Komplet - dy pjesë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Material i lehtë prej leshit të pastër; (60 % lesh, 20% poliester, 20% viskoz).</li> <li>Xhaketa e tëra me vija ose njëngjyrëshe;</li> <li>Dy pulla përpëra me jaka të palosura në formë të V-së dhe me vetëm dy hapje mbrapa; xhepat me kapakë dhe me vetëm një xhep në gjoks; katër pulla në mëngë</li> <li>Pantallonat të rrafshët përpëra me një pullë të shtuar si dhe me zip (zinxhir); xhepat në formë këndi dhe xhepin mbrapa të drejtë</li> </ul>	Komplet	48
2	Këmisha	<ul style="list-style-type: none"> <li>Jakat me maje</li> <li>Pullat përpëra – mëngët vetëm me një pullë</li> <li>E qepura e rrumbullakët poshtë</li> <li>Materiali i preferuar pambuk (80 % pambuk, 20% poliester).</li> <li>Mëngë të gjata</li> </ul>	copë	48
3	Kravata	Materiali 100% viskoz.	copë	48
4	Komplet - Setra dhe pantollona per femra për Inspektorarin e Punës Të jenë Elegante Përbajtja minimum Material i lehtë prej leshit të pastër; (60 % lesh, 20% polyester, 20% viskoz). Ngjyra të ndryshme ,Të thurur shpesh		Komplet	11
5	Këmisha	<ul style="list-style-type: none"> <li>Jakat me maje</li> <li>Pullat përpëra – mëngët vetëm me një pullë</li> <li>E qepura e rrumbullakët poshtë</li> <li>Materiali i preferuar pambuk (80 % pambuk, 20% poliester).</li> <li>Mëngë të gjata</li> </ul>	Copë	11

6	Shalli • Materiali pambuk (80 % pambuk, 20% poliester)	Copë	11
7	Furnizim me këpuca për zyrtarët e AIP-së (meshkuj) këpucë të thella lëkure me lidhëse.	copë	48
8	Furnizim me këpuca për zyrtarët e AIP-së (femra) këpucë lëkure të thella.	copë	11

1.2 Kontrata hynë në fuqi me *12.11.2020* dhe përfundon brenda 15dite nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se *15* ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vend i dërgimit të furnizimeve do të jetë për Inspektoratin e Punës

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>2</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).

#### Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksiioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

#### Neni 3 Çmimi

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: **9476,41€; [nëntëmijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë euro e katërdhjetë e një cent]** Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtronen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

#### Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale te pagesës pas pranimit të törë dërgesës]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

#### Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

<sup>2</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

## **Neni 6                    Kualiteti**

6.1 Kualiteti i *furnizimeve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

## **Neni 7                    Garancioni**

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *furnizimeve*.

## **Neni 8                    Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [*I'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat*] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *[furnizimeve]* të pa dorëzuar deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

## **Neni 9                    Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

## **Neni 10                  Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

## **Neni 11                  Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korupsion, përrshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmon ton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

## **Neni 12                  Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimesh nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

## **Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *Gjykata ekonomike e Prishtinës* në pajtim me ligjin e Kosovës.

## **Neni 14                  Komunikimi**

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen *Shqipe*<sup>3</sup> në tri origjinalë, dy origjinalë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	<i>Bajir Këbashi</i>	Emri:	<i>Feti Ibishi</i>
Pozita:	<i>Mesazher i Prok</i>	Pozita:	<i>Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit</i>
Nënshkrimi:	<i>Talayn Këbashi</i>	Nënshkrimi:	<i></i>
Data:	<i>12. 11. 2020</i>	Data:	<i>12.11.2020</i>
Vula:		Vula:	


<sup>3</sup> Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

**Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE**

Numri i Prokurimit: MPMS-209-20-016-136 - Titulli 'Furnizim me garderobë për AIP'

Nr ren dor	PËRSHKRIMI	Njësia materiale	Sasia	Cmimi për njësi me TVSH	Cmimi total me TVSH	Afat i liferimit
1	Pantalonat dje sakti (kutit) për meskujt per Inspektoratin e Punes Komplet - dy pjesë • Material i lëhta prej fesht te pastër, (60% fesh, 20% polyester, 20% viskoz) • Nshkruet e teta me vijrose njengjive shkëmbore • Dy pulla perputha me jaka te palosura ne formë te V-së dhe me vetem dy hapije mbroja, shepat me kipoke dhe me vetem një shep te gjoks, kater pulla ne mone • Pantalonat te nafshet perputha me një pulle te shtruar si dhe me zip (zinxhur), shepat ne formë kendi dhe sheputi mbroja te drejtë	Komplet	43	99.99	4,739.52	15 DITE
2	Kemisha - Jakat me mage • Pullat perputha - menget vetem me një pulle • E qejputa e minibullake poshtë • Materiali i preferuar pamuk (80% pamuk, 20% polyester) • Mengete grata	Copë	48	17.00	816.00	15 DITE
3	Kravata Materiali 100% viskoz	Copë	48	6.00	288.00	15 DITE
4	Komplet - Setja dje pantollona per femra per Inspektoratin e Punes - Te jone Elegante Pembla/za minunuri Material i lëhta prej fesht te pastër, (60% fesh, 20% polyester, 20% viskoz) • Ngjyra te ndisive • Te flumur shpejtë	Komplet	11	95.99	1,055.89	15 DITE
5	Kemisha • Jakat me mage • Pullat perputha - menget vetem me një pulle • E qejputa e minibullake poshtë • Materiali i preferuar pamuk (80% pamuk, 20% polyester) • Mengete grata	Copë	11	13.00	143.00	15 DITE
6	Shalli • Materiali pamuk (80% pamuk, 20% polyester)	Copë	11	3.00	33.00	15 DITE
7	Furnizimi me kepuca per zyratet e AIP-së (meskuj) kepuce te thella lekure me lëdhëse	Copë	48	33.00	1,624.00	15 DITE
8	Furnizimi me kepuca per zyratet e AIP-së (femrat) kepuce lekure te thella	Copë	11	37.00	407.00	15 DITE
<b>TOTALI I PËRGJITHSHËMI ME TVSH</b>						€ 9,176.41

VEMENDJE: OSE SHTE I OBLIGUAR TA KONTROLLOJ FORMULEN PARA SE TA PLOTOSOJNE RASTENDONJ GABIMI MBETET PËRGJEGJESI E OE

Nëshkrimi dhe Vula e OE	
IDENTIFIKIMI OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI/OLE:	SEYKOS SLLPK
EMRI/DHE MBIEMRI TE FERQËSUSIT TE OE:	SHPEJTIM KUCI
NËSHKRIMI:	
DATA:	06.10.2020
VULAJ:	